LIGJ
Nr. 134/2015

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9062, DATË 8.5.2003, "KODI I FAMILJES"

Në mbështetje të neneve 53, 54, 81, pika 2, shkronja "d", dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, "Kodi i Familjes", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 250 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

"Kur i mituri ka qenë strehuar që nga lindja e tij në një institucion, afati prej 1 viti kufizohet në 3 muaj dhe fillon nga data e lindjes.

Kur i mituri është gjetur i braktisur jashtë institucioneve të përkujdesjes sociale publike ose private, spitaleve apo maternitetеve publike apo private, afati prej 1 viti kufizohet në 3 muaj dhe fillon nga momenti i gjetjes së tij.

Kur i mituri është lënë nën kujdesin e institucioneve të përkujdesjes sociale, publike ose private, përfshirë spitalet publike ose private, nëpërmjet një deklarate noteriale të prindërve biologjikë për dhënien e tij për birësim, afati prej një viti kufizohet në 6 muaj dhe fillon që nga momenti i lënies së të miturit.".

2. Në fund të paragrafit të katërt shtohet fjalia e mëposhtme:

"Të tilla përpjekje nuk janë të nevojshme në rastin kur fëmija është lënë nën kujdesin e institucioneve të përkujdesjes sociale publike ose private, përfshirë spitalet publike ose private, nëpërmjet një deklarate noteriale të prindërve biologjikë për dhënien e tij për birësim.".

3. Paragrafi i pestë ndryshohet si më poshtë:

"Braktisja nuk deklarohet kur një gjykatë tjetër ka pranuar kërkesën e një të afërmi të fëmijës për caktimin si kujdestar të tij. Nëse gjykimi i një kërkese të tillë nuk ka përfunduar, gjykata pezullon shqyrtimin e kërkesës për deklarimin e braktisjes deri në përfundimin e tij.".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.12.2015

Shpallur me dekretin nr. 9367, datë 17.12.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani